

# Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar

## MESAZH NGA DREJTUESIT E PROGRAMIT AASF

Pas prezantimit të Buletinit tremujor të AASF si një kanal informues për të informuar palët e interesit të projektit dhe të interesuarit nga sektori bujqësor dhe financiar në fund të vitit 2018, ekipi AASF është i lumtur të ndajë edicionin e dytë të buletinit.

Ky botim jep një pasqyrë në përpjekje të vazhdueshme për të lehtësuar aksesin në financa për agrobizneset në Shqipëri dhe mbulon aktivitetet e fundit të AASF të kryera midis Tetorit dhe Dhjetorit 2019. Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF) është një kornizë financimi e zhvilluar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Qeverisë së Shqipërisë, e cila filloi veprimtarinë e saj në 2016.

Në këtë Buletin të dytë të AASF-së, do të mësoni më shumë rreth një seri takimesh ndërmjetësuese të AASF-së të mbajtura në Lushnjë, Korçë, Gjirokastrë, Sarandë dhe Malësi të Madhe. Më tej,

buletini jep një pamje të brendshme të procesit të vazhdueshëm të ngritjes së kapaciteteve të Agropikave, të fermerëve shqiptarë dhe të trajnimeve të mbajtura me Institucionet Financiare Partnere të AASF-së mbi mundësitë në financimin e sektorit bujqësor shqiptar.

Një nga pikat kryesore të këtij tremujori të fundit të vitit 2019 ishte edhe edicioni i tretë i panairit dy-ditor "Shqipëria punon tokën" në të cilin AASF mori pjesë në mënyrë të dukshme. Më shumë informacion mund të gjeni nën rubrikën Panairi Kombëtar të buletinit. Për më tepër, nën rubrikën e Publikimeve do të njiheni me Kartat e Riskut AASF, të cilat japin një përmbledhje në lidhje me

rreziqet që lidhen me bujqësinë dhe strategjitë e zbutjes në Shqipëri. AASF synon të mbështesë institucionet financiare shqiptare për të financuar një sektor jetik të ekonomisë shqiptare me një potencial të gjerë të pashfrytëzuar në bujqësi dhe agrobiznes.

Duke ju uruar të gjithëve një vit të ri të begatë dhe të lumtur, shpresojmë që ju të shijoni edicionin e dytë të Buletinit të AASF-së!

**Frieder Woehrmann**  
Drejtor i Programit, AASF

**Adela Leka**  
Zëvendësdrejtoreshë e Programit, AASF



## SHTYLLAT KRYESORE TË PROJEKTIT

### Risku i parë i humbjeve ("FLRC")

është një mekanizëm për rritjen e kreditimit të siguruar nga Qeveria e Shqipërisë, duke mbuluar 20% të humbjeve të shumës totale të nën-kredive të financuara me të ardhurat nga Linja e Kredisë së Agrobiznesit ose nga Shpërndarja e Riskutkut.



### Linjat e kreditimit të Agrobiznesit

si linjat e kredisë jo të sigurta për Institucionet Financiare Partnere në Shqipëri në financimin e subjekteve të agrobiznesit për investime afatmesme dhe afatgjata.

### Lehtësitë e shpërndarjes së riskut të Agrobiznesit

bazohet në pjesëmarrje në portofolin e pafinancuar, si një instrument i cili mbulon deri në 50% të shumës totale outstanding të portofolit të nën-kredive të Agrobiznesit.



### Asistencë teknike:

- Ndërtimi i kapaciteteve të për Institucionin Financiar Pjesëmarrës
- Asistencë teknike specifike për sektorin e agrobiznesit.

## 01 Aktivitete të rrjetëzimit

Gjatë muajit Tetor dhe Nëntor 2019, AASF organizoi një seri ngjarjesh informuese dhe ndërmjetësuese. Aktivitet u zhvilluan në rajonet e Lushnjës, Korçës, Sarandës dhe Malësisë Madhe. Qëllimi i këtyre eventeve ishte të informonim fermerët dhe agrobizneset shqiptare në lidhje me procedurat e aplikimit për të marrë mbështetje financiare nën Programin e AASF, dhe skemat e Mbështetjes Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (IPARD II) të mbështetur nga Bashkimi Evropian. Gjatë takimit, bizneset u njohën gjithashtu me programin "Këshilla për bizneset e vogla" (ASB) të BERZH-it, si dhe produktet dhe shërbimet financiare të ofruara për agrobizneset nga IFP-të.



## 02 Trajnime dhe seminare

AASF në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) zhvilluan një seri trajnimesh mbi skemat e njohurive teknike dhe të mbështetjes financiare për bujqësinë shqiptare në fund të vitit 2019. Të gjithë punonjësit e Agro-Pikave në zonat e mbuluara nga AZHBR, të tilla si Tiranë, Gjirokastrë, Pogradec, Fier dhe Shkodër, morën pjesë në trajnim, i cili kishte si qëllim të shpjegonte programin e AASF-së dhe përfitimet e tij për klientët bujqësorë dhe IFP-të dhe pajisjen e stafit të Agro-Pikave me aftësitë për të informuar klientët e mundshëm në lidhje me AASF-në. Trajnimi ofroi një përmbledhje të asaj çka fermerët dhe agrobizneset duhet të dinë që të aplikojnë për shërbime financiare të



ofruara nga IMF-të dhe mbi rolin e mundshëm që Agro-Pikat mund të luajnë në mbështetjen e tyre për të aksesuar shërbimet financiare.

Për më tepër, Programi AASF vazhdoi serinë e trajnimeve me Raiffeisen Bank, një nga Institutionet Financiare Partnere të AASF-s. Qëllimi i trajnimit ishte të përmbledhte të gjitha informacionet mbi potencialet dhe sfidat e sektorit të agrobiznesit në Shqipëri. Në këtë axhendë, trajnimi shpjegoi se si bankat mund të financojnë në mënyrë efektive nevojat e fermerëve dhe agrobizneseve shqiptare, rreziqet e lidhura me këtë sektor së bashku me mënyrat dhe mekanizmat lehtësues për bankat që, në fund të fundit, të rrisin financimin në këtë sektor. AASF prezantoi shifrat kryesore,

tendencat e sektorit, perspektivën e përgjithshme për investime në këtë fushë. Për më tepër, AASF prezantoi "Kartat Teknologjike të AASF-së" si një produkt i dobishëm, i cili mund të ndihmojë bankat të kryejnë vlerësime të kredisë bujqësore në mënyrë më efektive dhe të cilat mund të përdoren nga agrobizneset për të optimizuar prodhimin e tyre si dhe aplikimin duke zvogëluar humbjet në fermë ose kostot e tepërta.

## 03 Aktivitete promovuese

AASF mori pjesë në edicionin e 1-të Expo Forumit "Agro-Financimi dhe Siguria e Ushqimit në Shqipëri 2019" që u mbajt në Divjakë. Konfindustria organizoi aktivitetin në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkinë e Divjakës, AKU-në dhe AZHBR-në. Forumi u ofroi bizneseve dhe institucioneve financiare një platformë për të prezantuar produktet dhe shërbimet e tyre në fushat e bujqësisë me qëllim promovimin e mundësive dhe bashkëpunimeve të reja të biznesit.



## 04 Panairi Kombëtar

Më 16 dhe 17 nëntor, AASF mori pjesë në edicionin e tretë të panairit dy-ditor "Shqipëria Punon Tokën", organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Panairi i këtij viti pati pjesëmarrës të shumtë nga fusha të ndryshme, përfshirë rreth 400 fermerë dhe agrobiznese nga sektorë të ndryshëm bujqësorë si prodhimi i kulturave bujqësore, blegtoaria, prodhimi i bimëve medicinale, akuakultura dhe përpunimi i lidhur me fuhsat e ndryshme të bujqësisë. Më tej, patën rastin të marrin pjesë edhe përfaqësues



## AKTIVITETE

nga institucionet financiare që mundësojnë dhënie e huave në bujqësi dhe agrobiznes.

Gjatë këtij panairi, AASF promovoi Studimet e Zinxhirit të Vlerës dhe Kartat Teknologjike të AASF-së, si dhe informoi për ndihmën financiare dhe teknike të programit dhe mundësinë e marrjes së kredive nga Institucionet Financiare Partnere nën mbështetjen e AASF-së. "Shqipëria punon tokën" u mundëson fermerëve të komunikojnë me njëri-tjetrin për të shkëmbyer përvoja, të ndajnë histori suksesi dhe një vizion se si bujqësia shqiptare mund të zhvillohet më tej.



## PUBLIKIME

### MEKANIZMAT E ZBUTJES SË RREZIKUT SEKTORIAL

Në fund të vitit 2019, AASF përfundoi prodhimin e kartave të Mekanizmave të zbutjes së rrezikut sektorial, një seri prej nëntë kartash informuese të destinuara si produkte mbështetëse për Institucionet Financiare Partnere dhe agrobizneset. Për nëntë produktet më të rëndësishëm bujqësorë, kartat japin një përmbledhje të shpejtë të fakteve dhe zhvillimeve përkatëse të tregut

dhe shpjegojnë strategjitë më të rëndësishme zbutëse kundër rreziqeve që mund të ndikojnë potencialisht në produktin specifik. Duke mbuluar rreziqet e prodhimit, marketingut dhe rreziqet financiare, rreziqet ligjore, rreziqet menaxheriale dhe të lidhura me politikat, kartat mund të ndihmojnë agrobizneset të marrin vendime për mitigimin e rreziqeve dhe Institucionet Financiare për të promovuar financimin e investimeve për zbutjen e rreziqeve në bujqësi.



## PARTNERËT TANË

### ARDA

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është një agjenci kombëtare shtetërore që synon të mbështesë sipërmarrësit shqiptarë në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, duke përgatitur institucionin për të përfituar nga fondet e BE-së dhe donatorëve të tjerë. AZHBR po mbështet sektorin drejt ristrukturimit, modernizimit dhe specializimit në produkte dhe tregje specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit.

AASF është që prej vitit 2016 duke bashkëpunuar me AZHBR-në për të mbështetur fermerët dhe agrobiznesin



në Shqipëri përmes ndihmës teknike dhe mbështetjes financiare.

Linku: <http://azhbr.gov.al>



### Intesa San Paolo

Intesa Sanpaolo Bank është një bankë lider në vend që ofron një gamë të gjerë zgjidhjesh financiare, produkte dhe shërbime inovative për klientët e korporatave, klientët privatë institucional me të ardhura të larta, si dhe për biznese të vogla dhe të mesme dhe klientë individualë. Intesa Sanpaolo Bank ka një rrjet prej 35 degësh në qytete të ndryshme të vendit dhe po zgjerohet më tej strategjikisht në të gjithë Shqipërinë. Risia dhe përsosmëria e shërbimeve në Intesa Sanpaolo Bank Albania janë frymëzuar nga klientët e saj. Një nga strategjitë e Bankës në Shqipëri është zgjerimi i portofolit të saj në agrobiznes, duke mbështetur posaçërisht bizneset e vogla dhe fermerët me zgjidhje financiare të përshtatura.

Linku: <https://www.intesasanpaolobank.al/>



### Fondi Besa

Fondi Besa, me 80 zyra në të gjithë Shqipërinë, synon të jetë i pranishëm atje ku ka nevojë për zhvillim, duke ofruar mundësi hyrje për mijëra njerëz, duke i mbështetur ata me shërbime financiare, duke krijuar lidhje midis klientëve dhe mundësive dhe duke kontribuar në një zhvillim më të mirë ekonomik të vendit.

Linku: <https://fondibesa.com/>



### Pro Credit Bank

ProCredit Bank është një bankë tregtare e orientuar drejt zhvillimit. Banka ofron shërbim të shkëlqyeshëm për klientët për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për individët privatë që kanë aftësi për të kursyer dhe që preferojnë të kryejnë shërbimet bankare përmes kanaleve elektronike. Fokusi i tyre është tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pasi janë të bindur se këto biznese krijojnë vende pune dhe japin një kontribut jetik për ekonominë në të cilat operojnë. Një nga strategjitë kryesore për huadhënien është të mbështesin klientët që merren me prodhim dhe bujqësi.

Linku: <https://www.procreditbank.com.al/>



### Raiffeisen Bank

Raiffeisen Bank është një nga bankat më të mëdha në vend dhe gjatë 14 viteve të fundit e ka shndërruar plotësisht Bankën e vjetër të Shtetit në një bankë me shërbim të plotë, që shërben për të gjithë sektorët e biznesit dhe tregjet private individuale. Banka ka një gamë produktesh, procesesh, sistemesh dhe një infrastrukturë degësh që krahasohet në mënyrë të favorshme me standardet evropiane të shekullit XX. Raiffeisen Bank ofron gamën e plotë të produkteve dhe shërbimeve bankare në 4 sektorët kryesorë të biznesit në të cilët operon - individë privatë, mikro biznese, biznese të vogla dhe biznese korporative dhe i shërben më shumë 800,000 klientëve. Raiffeisen Bank mbështet agrobiznesin dhe fermerët në çdo aktivitet të biznesit të tyre përkundër madhësisë dhe pozicionit të tij në industri. Si çdo hua tjetër, edhe kjo është e strukturuar bazuar në ciklin e biznesit bujqësor.

Linku: <https://www.raiffeisen.al/>



### Otp Bank

OTP Bank si një lojtar kryesor bankar në Hungari dhe rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore ofron shërbime financiare me cilësi të lartë për më shumë se 18.5 milion klientë privatë dhe korporata në nëntë vende përmes pothuajse 1500 degëve, rrjeteve të agjentëve, 3900 ATM-ve, kanaleve elektronike dhe shërbimit online. Zhvillimi dhe zgjerimi i vazhdueshëm i OTP Bank ka kontribuar ndjeshëm në funksionimin e suksesshëm dhe efikas të grupit bankar, i cili ofron shërbime me cilësi të lartë si për klientët me pakicë ashtu edhe për institucionet. Megjithë konkurrencën e fortë, pozicioni i tregut të OTP Bank është i qëndrueshëm në disa segmente, si dhe përsa i përket përfitimt dhe stabilitetit, banka i takon vijës së frontit evropian. Megjithëse OTP Bank është e re në tregun shqiptar, sektori i agrobiznesit është një nga segmentet kryesore të synuara për mbështetjen e tyre financiare.

Linku: <https://otpbank.al/>



### AASF

Rr. Andon Zako Çajupi, No.7,  
Tiranë, Albania

(T): +355 69 294 1513

(E): [info@aasf.com.al](mailto:info@aasf.com.al)

(W): [www.aasf.com.al](http://www.aasf.com.al)

#### Na ndiqni në:

The Albania Agribusiness  
Support Facility (AASF)